



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT PËR ARSIMIN DHE SPORTIN
DREJTORIA E POLITIKAVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 1901 Prot.

Tiranë, më 01.4. 2022

Lënda: Për njohje dhe informim.


DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
Rr. "Aleksandër Moisiu", përballë IKV, Tiranë

Në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS) ka ardhur shkresa nr. 1329/1 prot., datë 18.03.2022 nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA), regjistruar në MAS me nr. 1901/1 prot., datë 23.03.2022, me lëndë: "Dërgohet informacion". Lutemi informimin e Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar në lidhje me shërbimet online "Vërtetim i notave të provimeve të MSH" dhe "Vërtetim i rezultatit të provimit të shtetit", që ofrohen në platformën e-Albania. Bashkëlidhur gjeni për njohje dhe informim shkresën e sipërpërmendur.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORIA E VLERËSIMIT

Nr. 1329/ Prot.

(Lutemi referojuni në rast përgjigje)

Tiranë, më 18.03.2022

Lënda: Dërgohet informacion

MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT

TIRANË

AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

TIRANË

Në vijim të shkresës së Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit nr.335/42 prot., datë 28.02.2022, "Mbi kthimin e përgjigjeve vetëm elektronikisht të aplikimeve në platformën e-Albania duke filluar nga data 1 mars 2022", e administruar në QSHA nr.1329 prot., datë 04.03.2022, lutemi mbi zbatimin e shkresës së mësipërme, gjëni problematikat sa më poshtë:

- 1 Në lidhje me shërbimin online "Vërtetim i notave të provimeve të MSH", vëmë në dijeni se ky shërbim mund të ofrohet në platformën e-Albania vetëm për maturantët/kandidatët, të cilët i përkasin MSH nga viti 2014 e në vazhdim. Përsa i përket maturantëve/kandidatëve të Maturave Shtetërore 2006-2013, ky informacion nuk është i disponueshëm në platformën e-Albania. Pra, kjo kategori qytetarësh nuk mund ta marrë shërbimin online "Vërtetim i notave të provimeve të MSH", në platformën e-Albania, pasi nuk i jepet mundësia të shkarkojnë vërtetimin.
- 2 Në lidhje me shërbimin online "Vërtetim i rezultatit të provimit të shtetit", vëmë në dijeni se ky shërbim mund të ofrohet në platformën e-Albania për të gjithë kandidatët, me përjashtim të kandidatëve që kanë dhënë provimin e shtetit, duke filluar nga 1 qershori 2021 e në vijim.

Duke qenë se jemi në këtë situatë, lutemi na sugjeroni si të veprojmë në lidhje me zbatimin e shkresës së mësipërme.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Aurora BALLIU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM